



# COMPINEWS

Periodike ndërlidhjeje



## Selia e Shenjtë Lektorati dhe Akolitati i dhënë grave

Papa Françesku drejtuar  
Prefektit të Kongregatës së  
Doktrinës së fesë: akses i  
grave në Shërbesat

## Kulti Hyjnor Shënim mbi Të mërkurën e përhime

Vatican News

## Kësh. Papn. Ungjillëzimi i Ri

24 janar: E diela e  
Fjalës së Zotit

Ndihmës liturgjiko-baritor



## > Marrëveshje me PUA dhe PAMI

Më 16 janar të këtij viti, në sallën e shna Ndout të Antonianumit (Romë), fra Massimo Fusarelli ka firmosur, edhe si përfaqësues i DPIK, marrëveshjet e bashkëpunimit mes Universitetit Papnor Antonianum, të përfaqësuar nga Rektori Prof. Agustin Hernandez Vidales, Akademisë Papnore Mariane Internationalis, të përfaqësuar nga Presidenti fra Stefano Cecchin, dhe COMPI-t. Objektivat e përbashkëta të marrëveshjeve janë ato të bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor dhe në programet akademike e kulturore, të angazhimit në realizimin e konferencave dhe kurseve të përditësimit e të shkëmbimit të informacioneve dhe materialit didaktik, me vëmendje ndaj ekologjisë dhe ndaj ekonomisë integrale, ndaj shtëpisë së përbashkët dhe ndaj personit njerëzor, ndaj dukurive kriminale e mafioze, ndaj dialogut poliedrik, ndaj financës së qëndrueshme e inovative, ndaj qytetarisë përfshirëse, ndaj dialogut mes myslimanëve dhe të krishterëve.

Urojmë që ky bashkëpunim të jetë i qëndrueshëm dhe i përhershëm, që të mund t'i bëjë të frytshme rrugëtimet e përbashkëta dhe gjithnjë e më krijimtare të karizmës françeskane.



## OFM

### Letra dhe Aktualitete

Në përkujtim të ipeshkvit Ruben Tierrablanca Gonzalez | Vullnetariati në shërbim të emigrantëve dhe refugjatëve | Toka e Shenjtë: Pagëzimi i Jezusit i kremtuar në kishën françeskane, ish-fushë e minuar | Festa e Protomartirëve të Urdhrit dhe mbyllja e Jubileut | fra Leonardo Sileo Rektor P.U. Urbaniana.

TË GJITHA LAJMET

### Fraternitas

Mensat françeskane | RIP: imzot Brogi dhe fra Perugini | Ven. SdD Seghezzi | Botime të reja | Franciscans International: Ndihmësi "Shembja e mureve" | Ministra & Kustodë të rinj | Axhenda e Ministrisë Gjenerale.

### Ekum & Dial

Java e lutjes për bashkimin e të krishterëve: "Qëndroni në dashurinë time: do të jepni shumë fryt" (Gjn 15, 5-9): tekstet jan. 2021 dhe intervista e bërë fra Tecele Vetralli-t.

## > Takim me M&E, F&S, DPIK dhe Ekum&Dial

Më 7 janar të këtij viti, Këshilli i Presidencës ka takuar në platformë Sekretarët M&E dhe F&S dhe Anim. komb. DPIK dhe Ekum&Dial. Takimi, i hapur dhe vëllazëror, ka lejuar të verifikohet itinerari që Sekretariatet dhe Sektorët kanë bërë, të nxitet ecja në këtë kohë pandemie dhe të shohiten disa perspektiva të ardhshme.

## > ... dhe të tjera

Vazhdon dialogu COMPI-CONFRES: më 3 shkurt Presidentët dhe Zëvendës-presidentët e dy Konferencave do të takohen për të shqyrtuar situatën mbi një tekst tashmë të punuar nga të dyja palët.

## > Nga Provincat

### Sh. Ndou – Italia Veriore

Saiano: Shkolla agroushqimore | Baccanello: në shtëpinë e baballarëve të ndarë | Verona: mirëpritja ndaj pozitivëve me Covid | Voltri: 50-vjetori i famullisë | Libri fra Pacifico Sella.

### Sh. Françesku – Umbria | Sh. Maria e Hireve – Sardenja

Dhënia e titullit Komendator i Republikës fra Salvatore Moritu-s dhe letra e tij.

### Sh. Bonaventura – Lacio-Abruco

Fëmija i Betlehemit | fra Carlo D'Andrea: një jetë pranë njerëzve dhe të varfërve | PGV | Greccio: ASL e Rietit dhe Oazit; Nata e grazhdit me fra Alessandro Brustenghi; vizita e kardinalit Tagle | Sh. Rufo: vëllazëri minore | Takimi kusht. përk. dhe prof. Marco Bartoli | Takimi under5 dhe don Alberto Ravagnani | Gjurmë të hebraizmit në shenjtin e Asizit.

### COMPI Qendër

Ministrat janë duke takuar në rrugë telematike Sekretarët dhe përgjegjësit e sektorëve, për të shqyrtuar ecjen e secilës Provincë dhe të Qendrës si e tillë.

### Të ngjiturit e Zojës – Pulja-Salento

25-vjetori i kanonizimit të shën Egjdit të Tarantos.

### Sh. Maria e Hireve – Sanio-Irpinia

Fra Marco Reynoso Tostado i shuguruar presbiter.

### Emri i Jezusit – Sicili

80-vjetori i unifikimit të Provincës.

## > Kalendar

**22 janar 2021** | Asambleja COMPI.